

No. 46960

**Argentina
and
Albania**

Agreement on trade and economic co-operation between the Government of the Argentine Republic and the Government of the Republic of Albania. Buenos Aires, 11 May 2000

Entry into force: *16 April 2003 by the exchange of instruments of ratification, in accordance with article 11*

Authentic texts: *Albanian, English and Spanish*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Argentina, 11 December 2009*

**Argentine
et
Albanie**

Accord de coopération commerciale et économique entre le Gouvernement de la République argentine et le Gouvernement de la République d'Albanie. Buenos Aires, 11 mai 2000

Entrée en vigueur : *16 avril 2003 par échange des instruments de ratification, conformément à l'article 11*

Textes authentiques : *albanais, anglais et espagnol*

Enregistrement auprès du Secrétariat des Nations Unies : *Argentine, 11 décembre 2009*

[ALBANIAN TEXT – TEXTE ALBANAIS]

MARREVESHJE

NDERMJET

QEVERISE SE REPUBLIKES SE ARGJENTINES DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE PER BASHKEPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK

Qeveria e Republikës së Argjentinës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me poshte, “Palet”,

Duke pasur parasysh rendesinë e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare ndërmjet Paleve,

Te nxitur nga dëshira e përbashkët për intensifikimin e marrëdhënieve të interesit dhe mirëkuptimit reciprok,

Te ndergjegjshëm për nevojën për të njësuar praktikën dhe rregullat e tregjeve ndërkombëtare si dhe të intensifikimit të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare,

Duke parë përpjekjet e Republikës së Shqipërisë për t’u bërë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe duke marrë në konsideratë detyrimet e Republikës së Argjentinës si anëtare e OBT,

Ranë dakort si më poshtë:

Neni 1

Palet do të bashkëpunojnë aktivisht për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre perkatese, parimet e Ligjit Nderkombëtar, duke u mbështetur në barazinë dhe përfitimin reciprok të tyre, si dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marreveshje.

Neni 2

Palet do t’i sigurojnë njëra-tjetres trajtimin më të mirë, duke respektuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me eksportin e mallrave të Paleve Kontraktuese të të dy vendeve, në përputhje me parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Megjithatë, dispozitat e këtij neni nuk do të zbatohen për avantazhe dhe privilegje të ofruara apo që do të ofrohen nga secila Pale.

Vendeve fqinje me qellim qe te lehtësojnë zhvillimin e tregtise nderkufitare.

Vendeve me te cilat secila nga Palet ka nenshkruar ose do te nenshkruaje ne te ardhmen nje marreveshje mbi bashkimin doganor, zonen e tregut te lire ose tregun e perbashket ose marreveshje te grupeve nderrajonale.

Neni 3

Palet do te nxisin zhvillimin e tregtise si edhe te prodhimit, investimeve dhe çdo lloj tjetër bashkepunimi ekonomik ne fushen e potencialit energjitik, energjitikes, industrise kimike dhe matalurgjike, prodhimit te mallrave te konsumit, eksplorimit, ruajtjes dhe perdorimit te duhur te burimeve natyrore, duke perfshire dhe burimet biologjike, transportin, telekomunikacionin, industrine e ndertimit, kompjuterizimin, bujqesine, industrine e ushqimit, turizmin dhe ekoturizmin, sherbimet dhe fusha te tjera me interes reciprok.

Neni 4

Eksporti dhe importi i mallrave dhe sherbimeve si edhe bashkepunimi ekonomik ndermjet Paleve duhet te kryhet mbi bazen e kontratave dhe marreveshjeve te tjera te nenshkruara nga persona fizike ose juridike te seciles Pale, ne perputhje me ligjet dhe rregulloret qe jane ne fuqi ne vendet e Paleve.

Mallrat me origjine nga Argjentina dhe Shqiperia, mund te rieksporthohen ne vende te treta, sipas rregullave nderkombetare te tregtise.

Neni 5

Palet do te nxisin bashkepunimin ekonomik dhe tregtar me qellim qe te kontribuojne, vecanerisht, megjithese jo ekskluzivisht, per:

riforcimin dhe persosjen e lidhjeve ekonomike dypaleshe;
eksplorimin dhe zhvillimin e tregjeve te reja;
promovimin e transferimit te teknologjise;
nxitjen e investimeve duke krijuar atmosferen e favorshme.

Neni 6

Palet do te nxisin:

marreveshjet per zhvillimin e bashkepunimit ekonomik ndermjet personave fizike ose juridike te seciles Pale;
pjesemarrjen e personave fizike ose juridike ne panaire te organizuara prej tyre;

shkembimin e delegacioneve te eksperteve ne fushen e ekonomise dhe tregtise; shkembimin e informacionit, veçanerisht ne lidhje me ndryshimet legislative dhe programet ekonomike Qeveritare, si dhe forma te tjera te kontratave te punes, duke kontribuar ne bashkepunimin ndermjet tyre.

Neni 7

Ne marredheniet reciproke ne fushat financiare, bankare dhe te sigurimeve, Palet do te zbatojne normat e aprovuara dhe te rekomanduara nga Fondi Monetar Nderkombetar (FMN) dhe Banka Nderkombetare e Rregullimeve (BIS me qender ne Bazel) dhe ne menyre te veçante, nuk do te imponojne kufizime per transaksionet ne llogarite rrjedhese dhe do te veprojne ne perputhje me ligjet dhe rregullat ne fuqi te vendeve perkatese.

Neni 8

Pagesat per transaksionet ne kuadrin e kesaj Marreveshje duhet te behen ne nje valute lehtesisht te konvertueshme, ne rast se Palet nuk bien dakort per ndonje menyre tjeter sipas ndonje transaksioni te veçante, ne perputhje me ligjin qe eshte ne fuqi ne secilin vend.

Neni 9

Per te arritur qellimet e kesaj Marreveshje, Palet duhet te krijojne nje Komision te Perbashket, i cili duhet te perbehet nga perfaqesues te secilit vend.

Komisioni i Perbashket duhet te:

Analizojë progresin e zbatimit te kesaj Marreveshje dhe propozojë masa per zgjidhjen e veshtiresive qe do te vihen re ne marredheniet ekonomike dypaleshe;

Gjejne mundesi te tjera per rritjen e bashkepunimit ekonomik dhe tregtar.

Komisioni i Perbashket duhet te takohet nje here ne vit ne Republiken e Argjntines ose ne Republiken e Shqiperise ne nje date te caktuar nga te dyja Palet.

Neni 10

Palet mund te bien dakort per ndryshimin e kesaj Marreveshje.

Pala qe ka marre propozimin per ndryshim, duhet te pergjigjet jo me vone se 60 dite pas marrjese se ketij njoftimi.

Keto ndryshime do te hyjne ne fuqi ashtu siç parashikohet ne Nenin 11.

Neni 11

Kjo Marreveshje do të hyjë në fuqi në datën e shkëmbimit të instrumentave perkatese të ratifikimit.

Kjo Marreveshje do të qendrojë në fuqi për 5 (pese) vjet dhe do të rinovohet automatikisht për periudha njëvjeçare, në rast se asnjëra nga Palet nuk njofton me shkrim Palen tjetër, për synimin e perfundimit të saj të pakten 3 (tre) muaj para perfundimit të seciles periudhe.

Perfundimi i kesaj Marreveshje nuk do të ndikojë në efikasitetin e veprimtarisë së bashkëpunimit, programeve ose projekteve të cilat janë zbatuar nga të dyja Palet, në rast se palet nuk bien dakort për ndryshime.

Neni 12


Menjëherë pas hyrjes në fuqi, kjo Marreveshje do të zëvendësojë plotësisht Marreveshjen Tregtare ndërmjet Republikës së Argjentinës dhe Republikës së Shqipërisë të nënshkruar më 20 janar 1987.

E nënshkruar në Buenos Aires më 11 maj 2000, në dy kopje origjinale në gjuhët spanjisht, shqip dhe anglisht dhe të gjitha tekstet janë autentikisht të njëjta.

Në rast se do të ketë probleme të interpretimit të Marreveshjes, duhet të merret parasysh teksti në gjuhën angleze.

PER QEVERINË E

REPUBLIKES SE ARGJENTINES



PER QEVERINË E

REPUBLIKES SE SHQIPERISE

